

**Shtojca 14.**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË  
AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE):** “CLIMACASA” shpk, me nr. NIPT: L07805502F, me adresë: LEZHE  
Lagjja Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati perdhe, Njesia me numer pronesia 5/82- N1, ZK Nr.  
8632

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

\* \* \*

Tipi i Kontratës: Shërbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: “**Procedure e hapur**”, mbi kufirin e larte monetarë

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 83489-04-27-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Mirëmbajtja e impiantistikës për Spitalin Rajonal Lezhë**”.  
Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të  
përcaktuara.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **28.04.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 30 datë 4  
Maj 2026**

## KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “ALTEC”

Emri i plotë i shoqërisë

K57923807W

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **16,596,400**  
(*gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind*) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “CLIMACASA” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

L07805502F

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 14.669.320 (*katermbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet*) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “KEVIN KONSTRUKSION” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K71401004W

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **14,208,668**  
(*Katermbëdhjetë mijon e dyqind e tete mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tete* ) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. B.O.E “ASI INVEST” shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

M01927023H  
Numri i NIPT-it

&

“COMPANY RIVIERA 2008” shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

K81716011V  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **14,750,600** (katërmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetemije e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. “ARTEO 2018” shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

L82523203F  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: nuk ka paraqitur oferte ekonomike

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. “KEVIN KONSTRUKSION” shpk

**K71401004W**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Arsyet e skualifikimit:** OE “KEVIN KONSTRUKSION” shpk me nipt **K71401004W** me dokumentacionin ligjor të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nuk plotëson pikën 2.3.1 të “Kapacitetit teknik”, në të cilën është kërkuar:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

*a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.*

*b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.*

Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk, për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, ka paraqitur kontratën me nr. 3242/2 prot. Date 02.09.2025, me objekt “Rikonstruksion I disa pavioneve të Spitalit Berat”.

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëherë prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstaton se kjo kontratë nuk përmbush elementin natyrë e ngjashme me objektin që prokurohet.

Kontrata objekt prokurimi është një kontratë shërbimi, ndërsa eksperiencën e mëparshme e paraqitur nga operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK është eksperiencë punimesh.

Në nenin 4 “Përkufizime”, pika 20 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni”, ndërsa në pikën 19 të po këtij neni parashikohet: “Kontrata publike për punë” janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre: a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik; b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune; c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës”.

Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 4 të LPP kontrata publike për shërbime ka si objekt kryerjen e shërbimeve, ndërsa kontrata publike për punë ka si objekt kryerjen e punëve ndërtimore,

pra në kontratën e shërbimeve, objekti është kryerjen e shërbimeve, ndërsa në kontratën e punës, objekti është një vepër ndërtimore ose një proces ndërtimi i plotë, që kërkon angazhim teknik dhe inxhinierik për realizimin e një pune.

Duke u kthyer në rastin konkret, KVO, konstaton se kontrata e prokurimit i përket kategorisë së kontratës publike të shërbimeve, ndërkohë kontratata me objekt “Rikonstruksion I disa pavioneve të Spitalit Berat”, të paraqitur nga operatori ekonomik në funksion të përmbushjes së kriterit 2.3.1 për shërbimet e mëparshme të ngjashme, i përket kategorisë së kontratës publike për punë, pasi përfshin një proces ndërtimor të plotë. Faturat e dala nga një kontratë pune nuk mund të konsiderohen si të ngjashme me kontratën e shërbimit, pasi ndryshon kategoria ligjore, objekti dhe natyra e shërbimit që prokurohet.

Kontratë publike shërbimi dhe kontratë publike për punë janë me natyrë krejt të ndryshme nga njëra tjetra, të cilat gjejnë rregullimin e tyre të posaçëm në LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. **Sjellim në vëmendje që ky qëndrim është mbajtur dhe nga ana e KPP me vendimin Nr.1323/2025, datë 24.09.2025.**

Sa më sipër arsyetuar, KVO, gjykon se operatori ekonomik me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumentave të tenderit.

**2 B.O.E “ASI INVEST” shpk**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**M01927023H**  
*Numri i NIPT-it*

&

**“COMPANY RIVIERA 2008” shpk**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K81716011V**  
*Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**Arsyet e skualifikimit:** B.O.E “ASI INVEST” shpk me nipt M01927023H & “COMPANY RIVIERA 2008” shpk me nipt K81716011V me dokumentacionin ligjor të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nuk plotëson pikën 2.3.1 të “Kapacitetit teknik”, në të cilën është kërkuar:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.*

a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të*

*deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.*

*b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.*

Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit operatori ekonomik “ASI INVEST” shpk ka paraqitur kontratën me nr. 4342/11 prot. Date 16.12.2024, me objekt “*Rivitalizimi I salles qendrore te pallatit te kultures “Shefqet Doda”*”, ndërsa operatori ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” shpk ka paraqitur kontratën me nr. 1592/21 prot. Date 11.07.2023, me objekt “*Rikonstruksoni I disa QSH-ve në qarqet Shkoder, Kukes, Lezhë, Diber*”

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, konstaton se kjo kontratë nuk përmbush elementin natyrë e ngjashme me objektin që prokurohet.

Kontrata objekt prokurimi është një kontratë shërbimi, ndërsa eksperiencat e mëparshme të paraqitura nga BOE janë eksperiencia punimesh.

Në nenin 4 “Përkufizime”, pika 20 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni”, ndërsa në pikën 19 të po këtij neni parashikohet: “Kontrata publike për punë” janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre: a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik; b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune; c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës”.

Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 4 të LPP kontrata publike për shërbime ka si objekt kryerjen e shërbimeve, ndërsa kontrata publike për punë ka si objekt kryerjen e punëve ndërtimore, pra në kontratën e shërbimeve, objekti është kryerjen e shërbimeve, ndërsa në kontratën e punës, objekti është një vepër ndërtimore ose një proces ndërtimi i plotë, që kërkon angazhim teknik dhe inxhinierik për realizimin e një pune.

Duke u kthyer në rastin konkret, KVO, konstaton se kontrata e prokurimit i përket kategorisë së kontratës publike të shërbimeve, ndërkohë kontratat me objekt “*Rivitalizimi I salles qendrore te pallatit te kultures “Shefqet Doda”*” dhe “*Rikonstruksoni I disa QSH-ve në qarqet Shkoder, Kukes, Lezhë, Diber*”, të paraqitura nga BOE në funksion të përmbushjes së kriterit 2.3.1 për shërbimet e mëparshme të ngjashme, i përket kategorisë së kontratës publike për punë, pasi përfshin një proces ndërtimor të plotë. Faturat e dala nga një kontratë pune nuk mund të konsiderohen si të ngjashme me kontratën e shërbimit, pasi ndryshon kategoria ligjore, objekti dhe natyra e shërbimit që prokurohet.

Kontratë publike shërbimi dhe kontratë publike për punë janë me natyrë krejt të ndryshme nga njëra tjetra, të cilat gjejnë rregullimin e tyre të posaçëm në LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të

tij. **Sjellim në vëmëndje që ky qëndrim është mbajtur dhe nga ana e KPP me vendimin Nr.1323/2025, datë 24.09.2025.**

Sa më sipër arsyetuar, KVO, gjykon se operatori ekonomik me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumentave të tenderit.

**3. “ARTEO 2018” shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L82523203F**

*Numri i NIPT-it*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**Arsyet e skualifikimit:** O.E “ARTEO 2018” shpk, me nipt **L82523203F** me dokumentacionin ligjor të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor dhe teknik për këtë procedure prokurimi.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

**1. “CLIMACASA” shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L07805502F**

*Numri i NIPT-it*

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 14.669.320 (katërbëdhjete milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.